

V E N D I M
datë 14.1.2003

I M B L E D H J E S S Ë G J Y Q T A R Ë V E T Ë G J Y K A T Ë S K U S H T E T U E S E

Në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, është paraqitur për shqyrtim kërkesa e zotit Fahri Balliu, kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.52 Elbasan, me objekt: "Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.1, datë 3.1.2003 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në shqyrtim paraparak të kërkesës,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbi bazën e rezultateve të zgjedhjeve të pjesshme për deputetë të datës 29.12.2002, në zonën zgjedhore nr.52 Elbasan, në raundin e dytë ka shpallur fituese kandidaten e Partisë Socialiste Znj.Valentina Leskaj.

Në lidhje me kërkesën e paraqitur nga kërkuesi, për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.1, datë 3.1.2003 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, arriti në përfundimin se shqyrtimi i saj përfshihet në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese dhe se kërkuesi legjitimohet në ngritjen e kësaj kërkesë.

Plotësimi i kushteve të mësipërme lejon kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

Nga shkresa nr.39 Prot., datë 10.1.2003 e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, rezultoi se ky organ ka filluar procedimin penal me nr.740, viti 2002, për veprën penale të parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal, ndaj shtabit elektoral të kandidates për deputete Valentina Leskaj.

Në këto kushte çështja e kaluar për shqyrtim në këtë Gjykatë do të pezullohet sepse ajo ka lidhje dhe nuk mund të zgjidhet para përfundimit të çështjes së mësipërme penale.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 e 45 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.
 - Pezullimin e gjykimit të çështjes deri në përfundim të zgjidhjes së çështjes penale me nr.740, viti 2002, filluar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.
 - Ky vendim i njoftohet kërkuesit, subjekteve të interesuara, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan si dhe bëhet publikimi i tij.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR: F. ABDIU

ANËTARË: A. KARAMUÇO, XH. ZAGANJORI, P. PLLOÇI, GJ. SAULI, S. SADUSHI

ANËTAR KUNDËR: Z. VUCI, K. PUTO